

Kosova në CEFTA:

Të jesh apo të mos jesh?

Përmbledhje ekzekutive

Kosova u bë anëtare fuqiptotë e CEFTA-s në korrik 2007, tetë muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes për anëtarësim. Marrëveshja për anëtarësim u nënshkrua nga UNMIK-u në emër të Kosovës. Tri vite pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, edhe më tutje Kosova përfaqësohet në CEFTA përmes UNMIK-ut. Më 2008 institucionet kosovare ndërruan edhe vulat doganore, nga *Doganat e UNMIK-ut* në *Doganat e Kosovës*. Mirëpo ky akt i vendosjes së simboleve të reja, nuk u përcoll edhe me veprime tjera konkrete, siç është insistimi për tu përfaqësuar si shtet i pavarur dhe jo përmes UNMIK-ut. Ndërrimi i vulave shërbeu si shkak për Serbinë dhe Bosnjë për të bllokuar eksportin e mallrave kosovare në këto dy shtete apo për të përdorur territorin e tyre për mallrat transit. Që nga 4 dhjetori 2008, kompanitë kosovare nuk mund të eksportojnë në këto dy vende. Për të mbajtur qëndrueshmërinë e tyre, kompanitë u detyruan që të gjejnë rrugë alternative: 1. Duke eksportuar mallin në Bosnje dhe Serbi përmes ndonjë shteti tjetër si ri-eksport; apo 2. Duke gjetur tregje të reja. Megjithatë këto rrugë alternative bartin kosto shtesë për bizneset vendore. Bllokada e Serbisë dhe Bosnjës gjithashtu dekurajon investitorët e huaj në Kosovë. Deficiti tregtar i Kosovës mbetet i lartë dhe ky deficit nuk është zbutur pas hyrjes së Kosovës në CEFTA, përkundrazi ai është rritur. Ky deficit po arrin vlerën e 2 miliard eurove. Përkundër ankesave të institucioneve vendore, si dhe letrave të dërguara nga PSSP (Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm) se ndërrimi i vulave nuk është në kundërshtim me Rezolutën 1244, Serbia dhe Bosnja vazhdojnë të bllokojnë mallrat kosovare, gjersa në të njëjtën kohë ato eksportojnë të papenguara mallrat e tyre në Kosovë. Me qëllim të mbrojtjes së ekonomisë vendore dhe prodhuesve kosovar, Instituti GAP rekomandon: institucionet të ndërmarrin masa provizore ribalancuese, të vendosen kuota për produkte të caktuara që importohen, shfrytëzimin e të gjitha mjeteve ligjore brenda CEFTA-s për të zgjidhur mosmarrëveshjet me Serbinë dhe Bosnjën dhe, në rast të mos gjetjes së një alternative, Kosova të largohet nga CEFTA dhe të lidh marrëveshje bilaterale me shtetet veç e veç.

HYRJE

Kosova është pjesë e CEFTA-s që nga viti 2007. Marrëveshjen e CEFTA-s në emër të Kosovës atë kohë e nënshkroi UNMIK-u, si autoriteti i vetëm i cili kishte të drejtë ta përfaqësojë Kosovën në marrëdhëniet me jashtë. Katërmbëdhjetë muaj pas nënshkrimit të CEFTA-s, Kosova shpalli pavarësinë e saj sipas modelit të propozuar nga ndërmjetësuesi i OKB, Ahtisaari. Sipas këtij modeli, i cili nuk kaloi në Këshillin e Sigurimit dhe nuk u pranua nga Serbia, autoriteti i UNMIK do të duhej të shpërbëhej, kurse prezenca e re ndërkombëtare do të kishte autoritet për mbikëqyrje dhe ndihmë në shtet-ndërtim.

Pasi që Pako e Ahtisaarit nuk kaloi në Këshillin e Sigurimit dhe Rezoluta 1244 për Kosovën është ende në fuqi, misioni i UNMIK nuk përmbylli misionin e tij. Edhe pse me kompetenca të kufizuara, UNMIK ende përfaqëson Kosovën në forumet ndërkombëtare, duke filluar nga mbledhjet e Këshillit të Sigurimit e deri tek marrëveshjet e nënshkruara nga UNMIK në emër të Kosovës. Ndër to edhe në CEFTA.

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, institucionet nuk artikulojnë një qëndrim të qartë sa i përket përfaqësimit të Kosovës në marrëveshjet ndërkombëtare. Pesë vite pas anëtarësimit të Kosovës në CEFTA dhe tri vite pas shpalljes së pavarësisë, opinioni kosovar është i ndarë në ata që mendojnë se Kosova duhet të qëndrojë në CEFTA dhe ata që mendojnë se Kosova duhet të largohet nga CEFTA.

Instituti për Studime të Avancuara GAP përmes kësaj analize do të përshkruajë CEFTA-n dhe zbatimin e saj. Çfarë përfitimesh ka Kosova nga të qenurit anëtar i CEFTA-s? Si ka ndikuar kjo marrëveshje në punën e bizneseve kosovare? Kush po e shkel marrëveshjen e CEFTA-s: Kosova, me ndërrimin e vulave doganore, apo Serbia dhe Bosnja, me bllokimin e mallrave kosovare? Çfarë qëndrimesh duhet të mbajnë institucionet kosovare kundruall CEFTA-s? Në fund, përveç rekomandimeve, do të gjeni edhe anekset e kësaj analize të cilat japin pasqyrat me indikatorët kryesor të tregtisë në kuadër të CEFTA-s.

Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA)

Me qëllim të lehtësimit të procedurave për tu anëtarësuar në Bashkimin Evropian (BE), vendet e Evropës Qendrore, Polonia, Hungaria, Republika Çeke dhe Sllovakia, më 1992, formuan Marrëveshjen për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA). Marrëveshja e CEFTA-s u bazua në konceptin e ekonomisë së tregut, pasi që shtetet anëtare mendonin se zhvillimi i mëtutjeshëm ekonomik mund të arrihet vetëm përmes promovimit të ekonomisë së tregut dhe konkurrencës së shëndoshë.

CEFTA është krijuar me qëllim të eliminimit të pengesave për tregtinë reciproke mes shteteve anëtare; krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin dhe diversifikimin e tregtisë; nxitjen e bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik; intensifikimin e marrëdhënieve ekonomike për përfitim reciprok dhe për kontributin në procesin e integrimit në BE; kontribut në zhvillimin e marrëdhënieve tregtare me BE-në dhe për integrimin në sistemin tregtar shumëpalësh¹.

Pas një periudhë shumë të shkurtër kohore, edhe shtete të tjera të Evropës Juglindore, kandidatë për tu anëtarësuar në BE, iu bashkuan CEFTA-s. Shtet që u anëtarësuan në CEFTA, pas katër vendeve themeluese, janë: Sllovenia (1996), Rumania (1997), Bullgaria (1998), Kroacia (2003), Maqedonia (2006), kurse më 2007 u anëtarësuan edhe këto shtete: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Mali i Zi, Moldavia dhe UNMIK-u në emër të Kosovës.

Si mekanizëm i përkohshëm, CEFTA nuk përjetoi vetëm anëtarësime, por edhe largime. Polonia, Hungaria, Republika Çeke, Sllovakia dhe Sllovenia iu bashkuan BE-së më 2004 dhe u larguan nga CEFTA². Tri vite më pas, edhe Bullgaria dhe Rumania lanë CEFTA-n, për t'iu bashkangjitur BE-së.

Siç tregojnë këta shembuj, CEFTA është një mekanizëm para-anëtarësimi në BE, funksioni kryesor i të cilës është që të arrijë një shkallë të tregtisë së lirë në mes të vendeve kandidatë për tu anëtarësuar në BE. Edhe pse jo e obligueshme, CEFTA është rrugë e pashmangshme për të gjitha vendet që aspirojnë BE-në.

CEFTA funksionon në tri nivele:

- **Komiteti i Përbashkët**, i cili udhëhiqet me rotacion.
- **Nën-Komitetet** (nën-komiteti i bujqësisë, sanitarisë dhe fito-sanitarisë; nën-komiteti i doganës dhe rregullave të origjinës, dhe nën-komiteti i barrierave teknike të tregtisë dhe barrierave jo-tarifore), dhe
- **Sekretariati i CEFTA-s** – i cili ndodhet në Bruksel

Kosova në CEFTA

UNMIK nënshkroi marrëveshjen e CEFTA-s në emër të Kosovës më 19 dhjetor 2006. Më 26 korrik 2007 Kosova u bë anëtare fuqplotë në CEFTA. Para anëtarësimit në CEFTA, Kosova kishte nënshkruar marrëveshje bilaterale të tregtisë së lirë, me Shqipërinë (2003), Maqedoninë (2005),

¹ Marrëveshje për Amendimin dhe Zgjerimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore.

² Marrëveshja e CEFTA-s, Neni 51 Kohëzgjatja dhe Denoncimi: “Palët bien dakord që në rastin e një pale legjitime që bëhet anëtare e Bashkimit Evropian, kjo palë tërhiqet nga kjo marrëveshje. Tërheqja kryhet jo më vonë se data para hyrjes në fuqi të anëtarësimit dhe pa kompensuar palët e tjera subjekt i kushteve të ndryshuara të tregtisë”.

Kroacinë (2006) dhe Bosnjën (2006). Këto marrëveshje u avancuan dhe u unifikuan në kuadër të CEFTA-s, pasi të gjitha këto vende u bënë anëtarë të kësaj marrëveshjeje multilaterale.³

Marrë parasysh se potenciali i zhvillimit ekonomik të Kosovës në të ardhmen do të duhej të bazohej në tregti, prodhim dhe eksport, CEFTA paraqitet si mjet i rëndësishëm për arritjen e këtyre objektivave. Si pjesë e CEFTA-s Kosova është e hapur për një treg prej afro 20 milion konsumatorëve dhe një BPV (Bruto Produkti Vendor) prej 120 miliard euro, e hapur për shkëmbim të eksperiencës tregtare, teknologjisë, konkurrencës, e njëherazi shërben si parapërgatitje për anëtarësimin në BE dhe Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT). Shfrytëzimi i plotë i përparësive të cilat rrjedhin nga Marrëveshja do të ndihmojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.

Megjithatë, Kosova nuk arriti që ti shijoj këto përparësi. Tetë muaj pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes së Kosovës me CEFTA, Kosova shpalli pavarësinë. Tri nga vendet anëtarë të CEFTA-s nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës.⁴ Si pasojë e kësaj, me insistim të Serbisë dhe Bosnjës, në të gjitha takimet e CEFTA-s Kosova edhe më tutje përfaqësohet nga UNMIK-u.


Që nga 4 dhjetori 2008, Serbia dhe Bosnja kanë ndaluar eksportin e produkteve kosovare dhe shfrytëzimin e territorit të tyre për transit. Shkak për këtë u bë ndryshimi i vulave doganore të Kosovës, nga Doganat e UNMIK-ut në Doganat e Kosovës. Këtë ndërrim të vulave, Serbia dhe Bosnja e konsideruan si shkelje të marrëveshjes së CEFTA-s.

Kjo bllokadë e vënë për produktet kosovare që në vitin 2008 uli nivelin e eksportit për 9.8%. Kompanitë kosovare të përballura me një bllokadë të tillë u detyruan t'i shfrytëzonin vendet e treta për t'u integruar në tregun rajonal. Por kjo alternativë nënkupton procedura të stërngarkuara, kohë më të gjatë dhe shpenzime më të larta për eksport. Përpos kompanive vendore, edhe investitorët e huaj në Kosovë po pësojnë nga kjo bllokadë. Një nga arsytet se përse investitorët e huaj nuk po e zgjedhin Kosovën si vend për të investuar, është për shkak se nga Kosova e kanë të vështirë të eksportojnë produktet e tyre në vendet anëtare të CEFTA-s. Natyrisht për investitorët më e leverdishme do të ishte të investonin në vendet tjera të CEFTA-s, prej nga të papenguar do të mund të eksportonin në të gjitha vendet e CEFTA-s. Anëtarësimi në CEFTA zgjeron tregun për Kosovën, nga një treg prej 2 milion banorësh në një treg prej 20 milion banorësh, dhe ky fakt është pikë e fortë në thithjen e investimeve të huaja direkte. Mirëpo, që nga 2007, investimet e huaja jo që nuk janë rritur, por ato kanë shënuar rënie të madhe. Mos zbatimi i plotë i marrëveshjes së CEFTA, është një ndër arsytet për rënien e investimeve të huaja direkte.

³ Sipas Annex 2 të Marrëveshjes për Amendamentimin dhe Zgjerimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, të gjitha shtetet anëtare të CEFTA obligohen që të prishin marrëveshjet e tyre bilateral tregtare, të cilat janë arritur para hyrjes në CEFTA.

⁴ Shtetet anëtarë të CEFTA të cilat nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës janë: Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Moldavia.

Figura nr. 1: Investimet e huaja Direkte



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Marrëveshja dhe rregullat e brendshme të CEFTA-s nuk parashohin si duhet vepruar në raste të tilla, kur një vend apo një grup vendesh bllokojnë mallrat e një vendi tjetër anëtar të CEFTA-s, duke shkelur në këtë mënyrë marrëveshjen për tregti të lirë. Sipas marrëveshjes së CEFTA-s⁵ palët që kanë mosmarrëveshje duhet ti zgjidhin ato me anë të bashkëpunimit dhe konsultimit në Komitetin e Përbashkët të CEFTA-s me qëllim të arritjes së një rezolute reciprokisht të pranueshme. Në rastet kur nuk mund të arrihet zgjidhja në kuadër të Komitetit të Përbashkët, atëherë brenda 90 ditëve kalendarike mund të merren masa provizore ri-balancuese⁶. Për më tepër, pala e dëmtuar pas 90 ditë konsultimesh të pasuksesshme mund t'i nënshtrohen procedurave të arbitrazhit. Nëse paraqitjen në gjykatën e arbitrazhit e kërkojnë më shumë se dy shtete anëtare të CEFTA-s atëherë ngrihet gjykata e arbitrazhit për këtë çështje, vendimi i të cilit është i prerë dhe detyrues për palët në mosmarrëveshje. Institucionet kosovare kanë dërguar disa herë ankesa tek autoritetet serbe, në Komisionin Evropian dhe në sekretariatit e CEFTA-s në Bruksel, por ato nuk shprehën gatishmëri për ta proceduar këtë shkelje edhe më tej, duke kërkuar nga Komiteti i Përbashkët t'i ndërmjetësojë konsultimet me Bosnjën dhe Serbinë, marrjen e masave provizore ri-balancuese apo edhe fillimin e procedurave të arbitrazhit.

Sipas UNMIK-ut, ndryshimi i vulave të doganave të Kosovës, nuk është në kundërshtim me Rezolutën 1244 dhe si rrjedhojë Kosova nuk ka shkelur marrëveshjen e CEFTA.⁷ PSSP i ka dërguar letra Serbisë dhe Bosnjës dhe i ka njoftuar për këtë. Sipas UNMIK, në vula nuk shkruan "Republika e Kosovës", por vetëm "Kosova", dhe kjo nuk paraqet shkelje. Megjithatë,

⁵ Marrëveshja për amendimin dhe zgjerimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore 2006, Kapitulli V, Dispozita të përgjithshme, Neni 23 dhe 24 dhe Kapitulli VII, Rregullat funksionale, Neni 42 dhe 43

⁶ Shpjegim: Me masa provizore ri-balancuese nënkuptohet marrjen e masave të përkohshme për mbrojtjen e produkteve vendore kundrejt një shteti i cili shkel Marrëveshjen dhe dëmton ekonomin e vendit.


⁷ Ky fakt përmendet edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën 2010.

edhe pas pranimit të shkresës zyrtare dhe pas kritikave nga BE, Serbia dhe Bosnja vazhdojnë ti mbajnë të bllokuara produktet kosovare në kufi.

Të dhënat tregtare të Kosovës

Që nga paslufta, Kosova përballet me deficit të lartë tregtar. Kosova importon shumë më shumë se sa eksporton. Edhe pse ndër vite, aftësia eksportuese e Kosovës ka shkuar duke u rritur, në të njëjtën kohë edhe importi ka shkuar duke u rritur, duke i mbajtur deficitin tregtar gjithnjë të lartë.

Figura nr.2: Eksporti dhe Importi në Kosovë



Burimi: Enti i Statistikave të Kosovës

Deri në 2007, eksporti i produkteve kosovare bëhej kryesisht në vendet e rajonit, gjersa që nga 2007, falë Marrëveshjes për Masat Autonome Tregtare në mes Kosovës dhe BE, tregu më i madh eksportues për Kosovës është BE. Marrëveshja për Masat Autonome Tregtare ka skaduar në dhjetor 2010 dhe deri më tani ajo nuk është rinegociuar. Në tabelën e mëposhtme kemi paraqitur eksportin dhe importin me BE-në dhe shtetet e rajonit.


Tabela nr.1: Eksporti dhe Importi me BE-në dhe Rajonin (në 1.000€)

Vitet	Eksporti		Importi	
	Rajoni	BE	Rajoni	BE
2004	23.510	16.248	368.701	378.144
2005	26.027	17.285	440.334	431.977
2006	51.745	28.602	536.254	391.335
2007	67.500	69.370	579.574	572.904
2008	61.534	93.974*	717.640	701.982*
2009	53.482	71.275*	692.465	755.004*
2010	70.933	131.460*	799.015	821.233*

* nënkupton se nga 2008 BE ka 27 vende anëtare
Burimi: Enti i Statistikave të Kosovës


Varësisht se në çfarë drejtimesh eksporton apo prej çfarë drejtimesh importon Kosova, kjo vërehet edhe nga ngarkesat e pikave doganore. Hani i Elezit dhe Kulla e Pejës janë pikat kufitare më të ngarkuara për eksport, ndërsa për import janë të ngarkuara dukshëm edhe pikat doganore në Mitrovicë dhe Merdare. Nga figura e mëposhtme mund të shohim se pas bllokimit të produkteve kosovare nga Serbia dhe Bosnja eksporti në pikën kufitare Merdare është zvogëluar për më shumë se dy herë, por ka rezultuar në rritjen e eksportit në pikën kufitare Hani i Elezit dhe Vërmicë, përderisa importi ka mbetur në trendin e njëjtë.

Figura nr.3: Eksporti sipas pikave kufitare



Burimi: Enti i Statistikave të Kosovës

Figura nr.4: Importi sipas pikave kufitare



Burimi: Enti i Statistikave të Kosovës

Ndikimi i CEFTA-s në ekonominë kosovare

Kosova nënshkroi marrëveshjen e CEFTA pa asnjë kusht. Edhe pse me Marrëveshjen e CEFTA-s është e lejuar që palët negociuese të vendosin kuota për produkte të caktuara, me qëllim që të mbrojnë prodhuesit vendor, Kosova nuk ka bërë një gjë të tillë. Kjo që në fillim paraqiti problem tek prodhuesit vendor të cilët nuk ishin konkurrent në tregun e tyre, meqenëse produktet e importuara ofrojnë çmime më konkurruese. Për më tepër të gjitha vendet rajonale anëtare të CEFTA-s vendosën kuota për disa produkte specifike, duke ia vështirësuar produkteve kosovare të jenë konkurrencte në ato tregje.⁸

Nëse analizojmë vlerat e eksportit me vendet anëtare të CEFTA-s mund të shohim se eksporti është rritur ngadalë pas anëtarësimit në CEFTA. Në vitin 2006 eksporti me vendet e CEFTA-s ishte 51.7 milion euro, përderisa në vitin 2010 kjo vlerë arriti në 70.9 milion. Një rritje prej 37% brenda 4 viteve, e që është një rritje jo e kënaqshme, kur marrim parasysh shkallën e vogël të eksportit në përgjithësi.


Tabela nr. 2: Eksporti me shtetet anëtare të CEFTA-s (në 1.000 €)

	Export						
	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Bosnja dhe Hercegovina	1,503	3,399	5,126	5,287	5,919	1,206	1,877
Mali i Zi	10,060	622	2,207	2,913	3,770	3,084	3,917
Serbia		6,265	20,910	19,280	9,893	3,504	3,846
Maqedonia	9,641	9,619	9,734	17,384	20,046	17,355	26,296
Shqipëria	1,793	5,240	12,645	20,799	21,113	26,182	32,288
Kroacia	513	882	1,123	1,837	793	2,151	2,709
Moldavia	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
Total	23,510	26,027	51,745	67,500	61,534	53,482	70,933

Eksporti shënoi rënie në vitin 2008 dhe 2009 e cila erdhi si rezultat i bllokimit të produkteve kosovare nga autoritetet serbe dhe boshnjake. Viti 2010 shënoi rritje të vogël të eksportit e cila erdhi si rezultat i rritjes së eksportit me Shqipërinë dhe Maqedoninë, shtete këto të cilat Kosova i përdori si rrugë alternative pas bllokimit nga Serbia dhe Bosnja.

⁸ Shembulli më i njohur është kuota e vendosur nga Shqipëria për patatet, për shkak se Shqipëria ka vendosur që të mbroj prodhuesit vendor të patates.

Figura nr.5: Eksporti me Bosnjën dhe Serbinë (në 1.000 €)



Burimi: Enti i Statistikave të Kosovës

Deri në vitin 2008, Kosova ka eksportuar në Bosnje me më së shumti nga këto kategori: 'Lëkura dhe artikuj të ngjashëm'; 'Ushqim, pije, duhan'; 'Artikuj punë dore'; dhe 'Metalet'; përderisa me Serbinë më së shumti ka eksportuar: 'Bazat e metaleve'; 'Ushqim'; dhe 'Perime'. Andaj dhe si pasojë e mbylljes së kufirit këto kategori edhe kanë pësuar më së shumti.

Kompanitë të cilat eksportojnë më së shumti më Bosnjën janë:

- "Adi" SH.P.K. – Lëkura të kafshëve të ndryshme
- "Viski Comerc" – Lëkura të kafshëve të ndryshme
- "Leather Holding" N.Sh. – Lëkura të kafshëve të ndryshme
- "Donna" – Lëkura të kafshëve të ndryshme
- N.T.P. "Laberion" – Lëngje Frutash
- "Fluidi" – Pije Energjetike, të gazuara, RC Cola
- "Ekocon" – shufra çeliku

Ndërsa kompanitë më së shumti që eksportojnë në Serbi janë:

- "EXIM Shped" – Gypa Çeliku
- "Trepça" – Mbeturina Metali
- "Stone Castle" – Verë e Bardhë, verë e kuqe
- "Haxhijaha" – Verë
- "Fungo", - këpurdha; dhe
- "Pestova" – patate dhe çipsa


Kompanitë kanë gjetur mundësi të tjera për të mos humbur tregun në tërësi. Shumica e kompanive kanë tentuar që problemin ta zgjedhin në dy mënyra:

1. Duke eksportuar mallin në Bosnje dhe Serbi përmes ndonjë shteti tjetër si ri-eksport, si p.sh. përmes Maqedonisë ku kostot e transportit janë rritur për 5-10%; dhe
2. Duke kërkuar tregje të reja në regjion.

Bizneset kosovare kanë zgjedhë këto rrugë si masa të përkohshme dhe, sipas tyre, nuk mund të aplikohen për një periudhë të gjatë kohore, ngase bartin kosto shtesë.

Kosova importon shumë më shumë nga Bosnja dhe Serbia, se sa që mund të eksportoj. Në vitin 2010 Kosova ka importuar 82.9 milion euro nga Bosnja dhe 260 milion euro nga Serbia.

Figura nr.6: Importi nga Bosnja dhe Serbia (në 1.000 €)



Burimi: Enti i Statistikave të Kosovës

Siç shihet nga këto të dhëna, vënia eventuale e bllokadës nga Kosova për produktet serbe dhe boshnjake, ekonomikisht i dëmton më shumë këto dy vende se sa Kosovën. Andaj është pak e besueshme se këto dy vende do të rrezikonin marrëdhëniet tregtare me Kosovën, në rast se Kosova vendos masa reciprociteti ndaj tyre. Nëse bizneset të cila eksportojnë në Kosovë vlera kaq të mëdha hasin në bllokadë, atëherë vetë ato do të kërkonin nga qeveritë e tyre të gjendet një zgjidhje.

Përmbledhje dhe Rekomandime

Kosova iu bashkëngjit CEFTA-s në kohën kur ajo po përballej me një deficit të lartë tregtar dhe ekonomi jo të zhvilluar. Anëtarësimi në CEFTA u pas si rrugëdalje nga kjo krizë, pasi që besohej se me integrimin në një treg të lirë më të gjerë, investitorët e huaj do të investonin në Kosovë, prodhuesit vendor do të kishin mundësi të eksportonin më lehtë dhe Kosova do të bënte një hap para drejt anëtarësimin në BE.

Pas katër viteve të anëtarësimin në CEFTA, asnjëra nga këto nuk ndodhi. Investimet e huaja u përgjysmuan, deficitin tregtar mbeti i njëjtë, prodhuesit vendor janë më të diskriminuar në krahasim me prodhuesit e vendeve tjera anëtare të CEFTA (qoftë si pasojë e mungesës së kuotave, por edhe si pasojë e pamundësisë për të eksportuar produktet në Bosnje dhe Serbi).

Për shkak të zhvillimit të ulët ekonomik, Kosova ka qenë e disfavorizuar në kuadër të CEFTA-s. Këtë e ka rënduar edhe më shumë bllokada e Serbisë dhe Bosnjës ndaj produkteve kosovare. Ky bllokim i produkteve vendore shënoi rënien e eksportit, duke e vështirësuar ekzistencën e kompanive vendore. Qeveria e Kosovës ndërroi vulat e doganeve, por nuk ishte e vendosur që ndërrimin e simboleve ta dërgoj deri në fund, duke insistuar në përfaqësim të institucioneve të Kosovës dhe jo përmes UNMIK-ut.

Të përballura me këtë krizë kompanitë vendore u detyruan të gjenin rrugë alternative për t'i eksportuar produktet e tyre. Kështu ato zgjedhën dy rrugë: 1. eksportimin e mallrave përmes një shteti të ri (e cila i rrit shpenzimet prej 5-10%) apo kërkimin e tregjeve të reja. E dyta ndikoi që eksporti me Bashkimin Evropian të rritet dukshëm, në të cilën ndikoi edhe marrëveshja për Masat Autonome Tregtare e nënshkruar më BE-në. Megjithatë në fund të vitit 2010 edhe kjo marrëveshje përfundoi, rinënshkrimi i së cilës po pengohet nga 5 vendet anëtare të BE-së të cilat ende nuk e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur.

Marrë parasysh këto dhe humbjet që po i shkaktohen Kosovës nga mos-aplikimi i Marrëveshjes së CEFTA-s nga ana e Serbisë dhe Bosnjës, Instituti për Studime të Avancuara GAP rekomandon:

1. **Vënien e masave provizore ri-balancuese.** Deri në arritjen e një marrëveshjeje me Serbinë dhe Bosnjën, Kosova duhet t'i rris tarifën doganore përkohësisht për produktet nga Serbia dhe Bosnja. Kjo do t'i ribalancojë përkohësisht humbjet e shkaktuara nga këto dy shtete. Rritja e tarifave doganore do të duhet të ndodhte pasi Kosova të ketë lajmëruar paraprakisht Komitetin e Përbashkët dhe vetë autoritetet në Serbi dhe Bosnje.
2. **Aplikimin e kuotave.** Qeveria e Kosovës duhet të përcaktojë kuotat për mbrojtjen e disa produkteve vendore, e cila do t'i sigurojë dhe do t'i bëjë më konkurrense këto produkte në tregun vendor, përball atyre të importuara.

3. **Hapjen e diskutimit në Komitetin e Përbashkët me Serbinë e Bosnjës**, ashtu siç e parasheh edhe Marrëveshja e CEFTA-s në rast të mos-marrëveshjes mes 2 apo më shumë palëve. Meqenëse Kosova e ka radhën e udhëheqjes së Komitetit, institucionet vendore duhet me doemos ta shtyjnë në agjendë diskutimin e mosmarrëveshjes dhe arritjen e një kompromisi të përbashkët. Nëse diskutimet nuk sjellin një marrëveshje të përbashkët brenda 90 ditëve Kosova duhet të procedojë çështjen në arbitrazh.

4. **Braktisja e CEFTA-s dhe nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale me shtetet veç e veç**. Statistikat tregojnë së Kosova nuk ka përfituar nga CEFTA ashtu siç është pritur në fillim. Nëse Kroacia do t'i bashkohet Bashkimit Evropian, dhe Bosnja e Serbia vazhdojnë t'i bllokojnë produktet kosovare në kufi, atëherë Kosova do të duhet të dilte nga marrëveshja e CEFTA-s dhe të nënshkruante marrëveshje bilaterale me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi. Aplikimi i masave të reciprocitetit ashtu siç është kërkuar nga bizneset kosovare nënkupton shkeljen e marrëveshjes së CEFTA-s dhe si e tillë do të ishte e papranueshme, andaj dalja nga kjo marrëveshje do të ishte zgjidhja më e mirë në këtë rast. Sidoqoftë, kjo duhet të mbetet opsioni i fundit, pasi të provohen të gjitha rrugët tjera ligjore.

Shtojcë: Të dhënat kryesore tregtare të Kosovës me vendet e CEFTA dhe BE

Tabela Nr. 3: Anëtarësimi në CEFTA

Shteti	Hyrja	Largimi
Polonia	1992	2004
Hungari	1992	2004
Republika Çeke	1992	2004
Slovakia	1992	2004
Slovenia	1996	2007
Rumania	1997	2007
Bullgaria	1999	2007
Kroacia	2003	Anëtare
Maqedonia	2006	Anëtare
Shqipëria	2007	Anëtare
Bosnja dhe Hercegovina	2007	Anëtare
Moldavia	2007	Anëtare
Mali i Zi	2007	Anëtare
Serbia	2007	Anëtare
Kosova	2007	Anëtare

Burimi: CEFTA 2006

Tabela nr.4: Eksporti dhe Importi në Kosovë (në 1.000 €)

	Eksporti	Importi	Bilanci Tregtar	Përqindja e mbulimit
2001	10.559	684.500	-673.941	1,5%
2002	27.599	854.758	-827.159	3,2%
2003	35.621	973.265	-937.644	3,7%
2004	56.567	1.063.347	-1.006.780	5,3%
2005	48.939	1.180.022	-1.131.083	4,1%
2006	110.774	1.305.879	-1.195.105	8,5%
2007	165.112	1.576.186	-1.411.074	10,5%
2008	198.463	1.928.236	-1.729.773	10,3%
2009	165.328	1.935.541	-1.770.214	8,5%
2010	294.031	2.139.534	-1.845.503	13,7%

Burimi: Enti i Statistikave të Kosovës

Tabela nr. 5: Eksporti me Rajonin dhe BE-në (në 1.000€)

Eksporti							
	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Bosnja dhe Hercegovina	1.503	3.399	5.126	5.287	5.919	1.206	1.877
Mali i Zi	10.060	622	2.207	2.913	3.770	3.084	3.917
Serbia		6.265	20.910	19.280	9.893	3.504	3.846
Maqedonia	9.641	9.619	9.734	17.384	20.046	17.355	26.296
Shqipëria	1.793	5.240	12.645	20.799	21.113	26.182	32.288
Kroacia	513	882	1.123	1.837	793	2.151	2.709
Moldavia	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
Total	23.510	26.027	51.745	67.500	61.534	53.482	70.933
Vendet e BE	16.248	17.285	28.602	69.370	93.974*	71.275*	131.460

Burimi: Enti i Statistikave të Kosovës

Tabela nr.6: Importi me Rajonin dhe BE-në (në 1.000€)

Importi							
	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Bosnja dhe Hercegovina	12.845	18.450	18.465	29.838	38.747	59.739	82.979
Mali i Zi	161.281	6.411	17.800	15.063	13.789	13.059	11.388
Serbia		152.257	191.053	222.534	208.951	210.901	260.156
Maqedonia	149.218	220.148	257.754	237.895	346.536	291.837	316.062
Shqipëria	20.237	18.093	23.108	35.262	59.632	58.385	69.092
Kroacia	25.120	24.975	28.074	38.982	49.985	58.544	59.338
Moldavia	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
Total	368.701	440.334	536.254	579.574	717.640	692.465	799.015
Vendet e BE-së	378.144	431.977	391.335	572.904	701.982*	755.004*	821.233

Burimi: Enti i Statistikave të Kosovës

Tabela nr.7: Eksporti sipas pikave kufitare (1.000 €)

Eksport							
	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Hani i Elezit	31.600	29.270	43.324	80.399	74.484	95.845	173.923
Kullë Pejë	6.520	6.450	4.402	10.111	71.158	19.705	29.652
Dheu i Bardhë	2.300	810	2.256	2.012	2.501	461	1.768
Mitrovica	9.916	4.235	29.117	37.925	13.971	19.705	27.519
Merdare	1.361	3.336	12.092	5.453	9.715	3.530	3.466
Aeroporti	1.481	348	2.948	3.172	6.155	3.534	8.584
Vërmica	2.823	3.278	8.033	12.210	11.134	12.653	37.195
Energji Elektrike	:	1.207	8.462	12.532	8.238	6.999	10.122

Burimi: Enti i Statistikave të Kosovës

Tabela nr.8: Importi sipas pikave kufitare (në 1.000€)

Import							
	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Hani i Elezit	521.552	587.878	576.796	673.062	794.164	685.974	687.914
Kullë Pejë	213.147	170.910	125.980	152.784	226.133	248.983	198.600
Dheu i Bardhë	36.446	41.658	81.486	66.550	57.486	74.059	80.687
Mitrovica	66.727	117.297	194.149	236.035	219.421	257.176	358.236
Merdare	46.450	65.261	130.568	152.285	211.998	219.774	271.892
Aeroporti	19.826	21.127	111.531	108.131	139.376	131.040	103.969
Vërmica	73.853	47.705	37.773	48.869	64.388	114.557	191.267
Energji Elektrike	19.171	16.723	24.548	47.836	57.424	51.005	38.487

Burimi: Enti i Statistikave të Kosovës

Tabela nr.9: Eksporti dhe Importi i produkteve

Produktet	Eksporti							Importi						
	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe	34	450	335	616	1,158	1,077	927	52,417	54,177	50,477	61,211	85,426	84,598	87,017
Produkte bimore	2,569	2,766	5,062	9,111	8,986	9,484	12,137	68,147	57,486	72,991	83,444	103,634	90,035	108,492
Yndyra	21	2	54	:	23	76	100	7,255	11,079	15,313	17,301	22,719	18,171	18,997
Ushqime të përg. pije dhe duhan	3,836	4,551	6,195	8,407	10,597	9,356	11,408	165,406	164,772	180,644	222,156	261,917	241,566	261,678
Produkte minerale	2,438	3,209	18,790	27,316	18,669	24,952	38,756	173,072	212,307	241,667	295,295	378,629	331,303	413,776
Produkte të industrisë kimike	1,021	956	1,174	889	1,773	1,482	1,323	97,966	91,366	107,730	119,858	138,783	142,902	146,615
Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre	3,675	912	3,214	6,514	6,476	6,357	8,030	42,500	51,016	60,677	72,764	86,082	95,748	108,098
Lëkurë dhe artikuj prej tyre	5,867	6,114	7,232	6,488	4,861	4,454	9,650	1,011	1,514	2,150	2,541	2,801	3,367	3,822
Druri dhe artikuj druri	434	417	758	1,712	1,730	876	1,248	29,921	30,724	30,305	35,429	41,685	44,922	48,983
Letër dhe artikuj prej letre	368	362	671	1,039	1,099	1,033	1,042	33,415	25,013	27,555	31,884	39,012	45,412	49,315
Tekstil dhe artikuj tekstili	1,371	581	724	1,224	2,536	5,241	8,329	31,154	36,741	45,122	53,036	63,982	69,089	71,568
Veshëmbathje të këmbëve	118	143	70	103	102	95	49	10,350	11,315	14,287	16,335	18,275	18,805	24,338
Art. prej guri, allçe, prod. qeramike dhe qelqi	1,819	354	716	1,218	1,460	1,240	1,402	54,948	51,487	56,994	63,028	67,195	73,465	84,705
Perla, gur të çmuar, metale të çmuara, etj	149	207	201	161	91	31	27	282	267	357	623	1,008	1,294	1,441
Metale baze dhe artikuj prej tyre	19,723	23,751	53,119	74,112	124,774	88,363	185,159	77,455	90,660	112,609	144,346	179,625	159,368	189,965
Makineri, pajisje mekanike dhe elektrike	9,164	2,711	7,658	21,326	8,789	7,206	11,312	116,765	133,924	153,315	203,422	239,927	278,689	288,239
Mjete transporti	1,980	921	1,398	1,504	2,342	1,620	1,468	50,218	110,332	79,341	95,907	131,148	162,215	155,947
Instri. Optike, mjeksore, fotog., muzikore, etj	1,141	214	274	438	652	529	357	15,054	16,080	14,265	19,269	21,410	23,091	35,055
Armët dhe municonet	2	:	2,474	:	:	:	0	459	166	481	360	368	410	4,976
Artikuj të ndryshëm të prodhuara	699	318	629	2,831	2,345	1,853	1,897	35,364	29,558	29,496	37,862	44,512	50,946	57,318
Verpat e artit	138	:	27	92	:	:	0	188	38	103	115	100	146	5,405

Burimi: Enti i Statistikave të Kosovës



Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Instituti për Studime të Avancuara GAP përkrahet nga:



Rockefeller
Brothers Fund

Philanthropy for an Interdependent World



OPEN SOCIETY INSTITUTE

& Soros Foundations Network